



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**10.01.2018, Prishtinë,
Ref:29.10.2017\588-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Bujar Lepajës kundër portalit Gazeta Express**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Bujar Lepajës kundër portalit të lajmeve Gazeta Express lidhur me artikullin "Dy miliardë të qe thyejnë ligjin antiduhan", botuar më 21 tetor 2017, dhe nxori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet

A R S Y E T I M I

Ankuesi Bujar Lepaja thekson se Gazeta Express ka keqpërdorur të drejtën e autorit duke botuar një fotografi që e ka bërë ai vetë pa autorizim të tij.

Në këtë rast bëhet fjalë për një artikull me titull: "Dy miliardë tërëqë thyejnë ligjin antiduhan", ku shihen Behgjet Pacolli dhe Lazim Destani.

KMShK, pasi shqyrtoi ankesën, konstatoi se nuk është kontestuese se autor i kësaj fotografie është Bujar Lepaja, por Gazeta Express e ka marrë fotografinë nga faqja zyrtare e Lazim Destanit e cila ishte e postuar në domenin publik. Kështu që me këtë rast nuk ka shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës